



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më  
31.3.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Berat Lahu (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Endrit Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

**Mungoi:** Granit Geci (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave.

FaqeInga14

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Valbona Ajeti**, propozoi që në rend të ditës të hynë si pikë për diskutim: "Propozimvendimi për ndarjen e një parcele për ndërtimin e xhamisë për banorët e lagjes afër rrugës "Muharrem Fejza".

Lidhur me këtë propozim, sqarime të nevojshme dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Mimoza Sylejmani, drejtore.

**Bahri Gashi**, kërkoi nga të pranishmit që propozimin e znj. Ajeti ta trajtojmë pak më seriozisht, ta fusim në rend të ditës, pastaj le ta vendos Asambleja, por jo të vendoset prej njerëzve individualisht.

**Sami Boroci**, ishte i mendimit që ky propozim i dhënë nga znj. Ajeti të shtyhen për në njërin nga seancat e radhës së Kuvendit, me arsyetimin se këtij propozimi i mungon materiali, kështu që të formulohet edhe më në detaje.

**Jeta Rafuna** tha se e përgëzoi znj. Valbonë për propozimin, mirëpo pajtohem plotësisht me kryetarin dhe me drejtoreshën dhe me zotimin e tyre që kjo temë të trajtohet gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal i cili pritet të vjen shumë shpejt në seancë.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e znj. Ajeti.

**Kryesuesi** konstatoi se më 16 vota për, 19 vota kundër dhe 2 abstenime, nuk hynë në rend të ditës për diskutim "Propozimvendimi për ndarjen e një parcele për ndërtimin e xhamisë për banorët e lagjes afër rrugës "Muharrem Fejza".

**Kryesuesi** konstatoi se më 37 vota për, u miratua ky

### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raportimi i kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
3. Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
4. Propozimvendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025;
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare, për z. Adhurim Uka, si pasojë e djegies së shtëpisë;
7. Informatë lidhur me fillimin e zgjedhjeve të kryetarëve të Këshillave Lokalë nga Drejtorja e Administratës;

Faqe2nga14

8. Pyetje dhe përgjigje;

9. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 39 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit**

*Gresa Lahu, i njoftoi të pranishmit rreth formimit të një grupin jo formal të asamblistëve për rininë e Prishtinës, grup i cili do të ofroj alternativa që kanë për qëllim përfaqësimin e çështjeve rinore me fokus zhvillimin dhe trajtimin me integritet të rinisë prishtinase.*

*Anëtarë të këtij grupi do të jenë nga një përfaqësues i të gjithave partive politike të përfaqësuara në Kuvend si në vijim:*

*Endrit Zabërgja, NISMA, kryesues,*

*Berna Saraçi, LVV, anëtare,*

*Sami Salihu, LDK, anëtar,*

*Gresa Lahu, PDK, anëtare,*

*Taulant Maxharraj, AAK, anëtar,*

*Sami Boroci, AKR, anëtar.*

**Pika e dytë**

**Raportimi i kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale**

Lidhur me kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar

**Nora Kelmendi**, në emër të GP të LVV-së fillimisht tha se, ju kryetar të njëjtin fjalim e keni mbajtur në shtatorin e vitit të kaluar vetëm pak e keni përmirësuar. Bazuar në Ligjin 06L092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Komuna ka për obligim që ta mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës sipas planit dinamik realizues, kështu që është obligim ligjor i kryetarit për të raportuar çdo gjashtë muaj për monitorimin dhe realizimin e këtyre kontratave. Mendoj se ky raportim i juaji po bëhet në mënyrë të gabuar. Ky raport duhet të ketë një hyrje, të ketë një përmbledhje të çështjeve për të cilat raportohet, duhet të ketë një përfundim, të ketë një rekomandim të bazuar në gjetjet e juaja dhe të komisioneve dhe mendoj se ky raport nuk ka arsyeshmëri, nuk ka konkluzion, nuk ka asnjë plan konkret. Kishte me qenë mirë që me kësi lloj raportesh që të mos talleni me ne, mos të talleni me qytetarët, e mos të talleni edhe me vetveten e juaj, sepse këto talljet e juaja të cilat po i bëni sot në Kuvend e përbëjnë një të vërtetë e cila e vërtetë po shihet sot në këtë Kuvend Komunal.

**Jeta Rafuna** tha se duke pasur parasysh raportimin që e paraqiti kryetari në Kuvend, kjo tregon se sa me përgjegjësi dhe transparencë ndaj qytetarëve e ushtron funksionin e tij i pari i Prishtinës, gjithashtu më vjen mirë që komisionet që ka themeluar kryetari janë në përfundim të punës së tyre, sepse është e vërtetë që kanë kaluar shumë vite pa veprimin e Komunës në raport me shfrytëzuesit pa kontrata të pronës komunale.

**Leutrim Retkoceri** tha se realisht është një raportim që përveç obligimit ligjor është edhe përgjegjësi para qytetarëve të Prishtinës të informohen më shumë se çka po ndodh me pronat komunale. Janë vendimet që i ka marr Kuvendi Komunal ato që edhe kryetari i prezantoi dhe i arsyetoi, mendoj se janë të qëlluara këto propozime që edhe kryetari i diskutoi, andaj dhe falënderoj kryetarin për raportimin e sotshëm për këto prona.

**Gëzim Mehmeti** tha se është obligim ligjor çështja e raportimit po ashtu edhe veprimi i kryetarit është pozitiv në këtë rast, po në anën tjetër si dukuri negative e shoh çështjen e materialeve d.m.th. është shumë, shumë sipërfaqësore, ka mungesë të detajuar ashtu siç parashihet me ligj sa u përket raportimeve. Kërkoj nga kryetari që ta marr një zotim publik për rritjen e transparencës, që të gjitha kontratat prej vitit 1999/2000 që ne i kemi në sirtarin, në arkivin e Komunës të publikohen, kështu që në këtë rast ne përveç që kemi obligim ligjor atëherë i kemi edhe borxh qytetarëve të dinë se si veprohet me dhënien e pronave, si në të kaluarën dhe tani.

**Gëzim Sveçla** tha se pika e rendit të ditës nuk ka të bëjë me lirimin e pronave komunale, jemi të thirrur në këtë pikë të rendit të ditës të flasim për kontratat, për pronën komunale e cila është dhënë me qira jo për atë që është liruar. Në këtë kuptim na janë prezantuar 4 kontrata në materialin të cilin na e keni dërguar, dy prej të cilave siç e dimë të gjithë nuk e kanë kaluar ligjshmërinë në MAPL, por megjithatë janë të prezantuara këtu si kontrata. E inkurajoj kryetarin që ta përshpejtoj pak këtë proces për shkak që nuk po më duket logjike nëse kërkojmë prona prej nivelit qendror ndërkohë që kemi shumë prona komunale me kontrata të pavlefshme tanimë, kështu që deri sa nuk kanë kontratë valide i bie që janë uzurpuara pa marr parasysh kush janë uzurpatorët. Po ashtu kërkoj të dijë se a ekziston ndonjë mekanizëm i cili është duke e bërë monitorimin e këtyre kontratave a janë duke u plotësuar, kështu që ditëve të fundit kishim një rast në media për "Spitalin Ameriakn" i cili ndodhet në pronën komunale afër QKUK-së dhe ku disa kushte me të cilat është liruar ajo hapësirë për atë spital me informacionet që kemi nuk janë respektuar fare.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit për Raportin e kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

**U konstatua se u përkrah Raporti i kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtore.

**Gëzim Mehmeti** tha se ne rëndësinë e bartjeve e kemi parasysh dhe është shumë me domethënie për projektet e Komunës së Prishtinës dhe qytetarëve të saj, por për mua është pak shqetësuese të dëgjoj tani rreth këtyre rrethanave e gjërave të reja, kështu që mendoj se kjo çështje nuk është shumë e lehtë, sepse ne nuk kemi asnjë dokument se si ti qasemi kësaj çështje, ka një amulli dhe nuk jam duke e kuptuar, kështu që kërkoi që ne të jemi të informuar me shkrim, ta dimë se për çka po votojmë, dhe mos të bëjmë shkelje.

**Gëzim Sveçla** tha se për dokumentin për të cilin po flasim tashmë është ligj, pra Ligji për buxhetin, i nënshkruar nga Presidentja dhe i cili ka hyrë në fuqi. Në këtë rast në një farë mënyre për shkak të pakënaqësisë që është krijuar me apo pa të drejtë, gabim teknik apo politikë fiskale, ne si Asamble ka rrezik të vijmë para një lajthitje. Ka rrezik që ne të votojmë sot për ndarje të disa mjeteve të cilat realisht nuk i kemi fare, të cilat ne nuk i posedojmë si Komunë, nuk i kemi në dispozicion dhe kjo pastaj pashmangshëm se nuk e kalon ligjshmërinë të Ministria e Financave dhe MAPL-ja, prandaj nëse ka afat kohor, është mirë që si pikë të rendit të ditës ta tërheqim sot deri të sqarohet saktë se cila është shuma e mjeteve për të cilën do të votojmë.

**Fiknete Bejta** tha se ne sot po votojmë për një pikë të rendit të ditës që ka shumë impakt pozitiv në jetën e qytetarëve, pra për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga buxheti i vitit 2022. Ndihem e shqetësuar për informatën e dhënë nda znj. Makolli, dhe në emër të grupit parlamentar lus Ministrin e Financave, po besoj që është gabim teknik e që këtë gabim teknik ta korrigjoj dhe mjetet vetanake të akumuluar në buxhetin komunal, t'i dedikohen qytetarëve të Kryeqytetit. Nga shuma prej 51 milion e 425 mijë e 219 euro, mjetet e pa shpenzuara nga viti 2022, janë mbi 46 milion euro të parapara për investime kapitale, ndërsa një pjesë me e vogël mbi 4 milion euro janë të tejkalimit të planit për arkimin e të hyrave vetanake të vitit 2022.

E kemi diskutuar disa herë që këto mjete kanë mbetur të pa shpenzuara edhe me fajin e nivelit qendror për shkak të vonësës së konstituimit të organit shqyrtues të prokurimit, por edhe për shkak të ndërprerjeve të kontratave nga ana e operatoreve ekonomik, për shkak të problemeve me rritjen e çmimeve të lëndës së parë dhe kryesisht të krizës globale ekonomike.

Në emër të grupit parlamentar, ju kërkoi që këtë bartje ta votojmë unanimisht, pra duke mundësuar që të implementohen projektet aq të nevojshme për Kryeqytetin dhe qytetarët e Prishtinës.

**Feim Osmani**, fillimisht tha se këtu po ngritët një konfuzion për të cilin se kemi ditur me përpara me trajtuar edhe me hulumtuar dhe me parë mënyrën qysh është votuar në nivelin qendror.

Po ti referohemi tabelave të këtij dokumenti, shihet se aty ka kontrata që janë të viteve 2018/2019/2020 etj dhe nuk është dhënë asnjë sqarim pse nuk janë shkëputur kontratat ose pse kanë ngecë kryerja e punimeve, mirëpo ka ardhur si pozicion për me e bartë në vitin 2023. Lidhur me këtë mendoj se herëve tjera është mirë me pasur edhe një sqarim shtesë për projektet e ndryshme se ku kanë ngecur në mos realizimin e tyre, a i ka skaduar afati dhe nuk mund të vazhdohet apo është në procedurë e sipër e nuk ka mundur me përfunduar për shkaqe tjera që ne me e pasur më të qartë çka po votojmë dhe qysh po votojmë. Mendoj se kjo pikë duhet të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në njërin nga seancat e radhës së Kuvendit.

**Triera Kasumi-Berisha** fillimisht ceku se sa i perket aspektit profesional, eshte dashur qeverisja komunale te marr ne opinion ligjor nese ka pasur konfuzitet sa i perket ligjit, sepse besoj qe ne nuk kemi te drejte te interpretojmë ligje ne menyren qysh ne i perceptojmë, keshtu qe mendoj se do te kishte qene me se e nevojshme qe ne paraprakisht ketë çështje ta kishim diskutuar te paktën ne ndonjë seancë të jashtëzakonshme, për ta qartësuar ketë çështje jo të dalim ne para një akti të kryer për të votuar diçka mbi të cilën kemi konfuzitet. Neve na duhet pak kohë për ta diskutuar, për ta procesuar, për ta verifikuar dhe pastaj për të ardhur para aktit të kryer për të votuar dhe mos të na servohet një pikë për votim të cilën ne ndoshta nuk jemi të gatshëm ta votojmë.

**Leutrim Retkoceri** tha se për çështjen e bartjes kur ka ndodhë edhe vitin e kaluar ka ardhur si rezultat i disa vendimeve që janë të pashmangshëm edhe në nivelin qendror. Ne e kemi pasur më herët një situatë kur Ministria e Financave ka tentuar ti marrë të hyrat vetanake të komunave, është tërheq nga Ligji i buxhetit për vitin 2023, dhe për këtë arsye buxheti i krejt Republikës së Kosovës është votuar në Kuvend. Problemi është që ka qenë gabim që nuk është sfiduar Ministria e Financave dhe Qeveria në momentin kur ka lejuar rishikim të buxhetit vetëm për Ministri e jo edhe për komunat dhe organizatat e tjera buxhetore. Ne nuk e kemi një opinion ligjor përpara që mundet me e sqaruar, nuk jemi edhe aq kompetent që me diskutuar buxhetin e Republikës së Kosovës, që është për të gjitha komunat, jo veç për këtë komunë, dhe jam i bindur që komunat tjera veç kanë filluar me bërë bartjen, pra jemi para një situatë ku mendoj që hapja rrugë i ndihmon proceseve për të punuar diçka për Prishtinë e mendoj që Prishtinën e kemi të gjithë së bashku.

**Hafiz Krasniqi** tha se sa i perket çështjes së bartjes së mjeteve të komunave, keshtu qe na jemi asamblistë të Kuvendit të Kryeqytetit dhe detyrë e jona është që ne ta mbrojmë interesin e qytetarëve të Prishtinës, dhe nuk di që ka akt më të lartë se sa ne si asamblistë të përkrahim zhvillimin e Kryeqytetit dhe në këtë rast besoj që ligjshmëria është në anën tonë, dhe besoj që është akt moral i secilit asamblistë për ta votuar këtë çështje.

**Mirsad Vitia**, fillimisht ceku se me avazin e punëve në terren Komuna jonë rrezikon të mos realizoj projekte të shumta nëpër lagje dhe fshatrat e Prishtinës. Me kohë kemi paralajmëruar ekzekutivin komunal se kësaj qeverisje do ti teprojnë në fund të vitit dhjetëra miliona euro dhe ja ku jemi sot, me mbi 51 milion euro për bartje të tyre nga viti 2022 në vitin 2023, ku mbi 6 milion euro janë të pa shpenzuara nga kategoria e investimeve kapitale. Shumë projekte të planifikuara tashmë janë edhe të vonuara, madje ka mundësi disa edhe të mos realizohen gjatë vitit aktual. Deri sa Komunës sonë i teprojnë miliona euro të pa shpenzuara dhe nuk di se si e ku ti investojë ato, lagjet si Veterniku apo Prishtina e Re, vazhdojnë të mbesin pa çerdhe, pa shkollë, pa bashkësi lokale, pa shtëpi kulture, pa mbulim të ujërave të zeza, pa trotuare etj. Një qytet me nevoja nga më të ndryshmet vazhdon të mbes në kaos, me zhurmë, pluhur, mbeturina, qen endacak, rrugë të bllokuara, sheshe të shfrytëzuara nga taksi e minibus ilegal, trotuare të zëna, parqe të betonuara, prona publike të uzurpuara, etj.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit rreth bartjes së mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023, sqarime shtesë dhanë Valbona Makolli, drejtore, Përparim Rama, kryetar dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Gëzim Sveçla**, LVV, për anëtarë të komisionit propozoi Berna Saraçin dhe Gëzim Sveçlën; **Sami Salihu**, LDK, për anëtarë të komisionit propozoi Fiknete Bejtën dhe Amir Simnicën; **Shegë Beqiri**, PDK, për anëtar të komisionit propozoi Muhamet Selmanin; **Kushtrim Mushica**, AAK, për anëtar të komisionit propozoi Bahri Gashin; **Gëzim Mehmeti**, AKR, për anëtar të komisionit propozoi Sami Borocin; **Endrit Zabërgja**, NISMA, për anëtar të komisionit propozoi Endrit Zabërgjen.

**Kryesuesi** tha se nga ekzekutivi për anëtarë të komisionit janë propozuar: Veton Krasniqi, përfaqësues nga Drejtorja e Urbanizmit, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

**Me emrat e anëtarëve të propozuar për komisionin përkatës, kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025**

Përkitazi me Propozimvendimin për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Adelina Sahiti, drejtore.

**Violeta Salihu** tha se GP i LVV-së në parim e përkrah Planin e veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, të cilin për aq sa e analizuam na u duk shumë ambicioz dhe për afrimi i realizimit të aktiviteteve të planifikuara do të ishte shumë i dëshiruar për të gjithë ne, sepse përfitues direkt të këtij plani do të jenë shtresat më të cenuara të shoqërisë. Personat që kanë kontribuar në këtë plan të veprimit janë kompetent për shërbimet sociale në fusha të ndryshme dhe padyshim se objektivat e planit janë të harmonizuara me

Faqe7nga14

objektivat e Planit të veprimit në nivelin qendror për mirëqenien sociale. Një memorandum mirëkuptimi në vitin 2008, lidhur mes Ministrisë së Pushtetit Lokal atëherë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Financave, rezultoi me një decentralizim të shërbimeve nga niveli qendror në lokal, i cili nuk rezultoi të jetë i suksesshëm.

Edhe ekzekutivi i Komunës së Prishtinës, duhet të gjej mekanizma shtesë në ofrimin e përkrahjes dhe mbështetjes së QPS-ve, në të gjitha linjat që ata ballafaqohen me vështirësi, që t'iu ofroi qytetarëve shërbime më cilësore të cilat si rrjedhojë ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së tyre. E përgëzoi drejtoreshën lidhur me veprimet që i ka paraparë me themelimin e grupit për monitorim dhe mbajtjen e takimeve të rregullta në baza tre mujore, sepse vetëm në bazë të monitorimit do të kemi një pasqyrë për hapat e ardhshëm që do të merren, qoftë për përmirësim qoftë për perfeksionim të aktiviteteve.

**Elmire Nikçi -Rexha** tha se nga analiza që i kemi bërë këtij plani, kemi konstatuar se ky veprim është hartuar dhe është bazuar në hulumtimin e gjendjes në terren dhe në analizën e raporteve që e trajtojnë mirëqenien sociale, pra po shihet që është një plan me vizion të qartë, e që ka për bazë përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të Prishtinës, andaj edhe jemi pro këtij plani të veprimit.

Lidhur me disa çështje të ngritura që kishin të bënin rreth shërbimeve sociale në Komunën e Prishtinës, sqarime shtesë dhanë Adelina Sahiti, drejtore dhe Besianë Musmurati, drejtore.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri më 37 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka, si pasojë e djegies së shtëpisë.**

Arsyeshmërinë për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka, si pasojë e djegies së shtëpisë, e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri më 40 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka, si pasojë e djegies së shtëpisë.

#### **Pika e shtatë**

**Informatë lidhur me fillimin e zgjedhjeve të kryetarëve të Këshillave Lokal nga Drejtoria e Administratës**

Arsyeshmërinë lidhur me fillimin e zgjedhjeve të kryetarëve të Këshillave Lokal nga Drejtoria e Administratës, e paraqiti Bersant Beka, drejtor.

**Gëzim Sveçla**, kërkoi të dijë se cila do të jetë mënyra e identifikimit të banorëve të lagjes të cilët marrin pjesë në këshill, në çfarë forme do të identifikon ata që janë banorë të lagjes dhe kanë të drejtë të jenë të propozuar ose të votojnë, dhe si do të bëhet mënyra e zgjedhjes së kryetarit të këshillit në këtë rast.



Lidhur me pyetjen e z. Sveçla, Bersant Beka, drejtor dha sqarime të nevojshme.

**U konstatua se u përkrah Informata lidhur me fillimin e zgjedhjeve të Kryetarëve të Këshillave lokal nga Drejtoria e Administratës.**

**Pika e tetë**

**Pyetje dhe Përgjigje.**

**Sami Boroci, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe për Shërbimin e Kuvendit**

- A do të kishte mundësi që kjo drejtori apo Komuna me e ndërruar orarin e punës të çerdheve publike me bazë në komunitet, pasi që punojnë vetëm deri në ora 16:00 dhe deri në ora 16 është sfidë shumë e madhe për prindërit me mbërri me dal prej punës dhe me shkuar me i marr fëmijët në ato çerdhe.
- Po i shoh disa fotografë që po sillen këtu në sallë, kërkoi të dijë se a janë fotografë të Kuvendit apo të partive.

Për pyetjen e parashtruar nga z. Boroci, përgjigje dha Besianë Musmurati, drejtore.

**Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Deri ku ka shkuar problemi i kanalizimit për fshatin Rimanishtë, sepse nuk kam detaje rreth këtij projekti. Më intereson ta di se ku jemi me atë projekt dhe pse dikush jashtë organit të Bashkësisë Lokale me dhënë informata aq të sakta kur e dimë që nuk është as zyrtar i drejtorisë e as inxhinier. Përse po ndodh kjo, jo vetëm tash por edhe në të kaluarën.
- Pse nuk është paraparë në buxhet meremetimi i rrugës "Njësi Buna" Besi-Rimanishtë dhe kërkesën që e kemi parashtruar e kemi marrë zotimin që ajo do të futet në buxhet dhe nuk është futur në buxhet dhe nuk është paraparë as meremetimi e as çështja e trotuarit, nuk është bërë as krasitja e shkurreve në të dy anët e rrugës të cilat po e pengojnë qarkullimin dhe e kanë bërë jashtëzakonisht të vështirë dhe problematik.

Për pyetjen e parashtruar nga z. Osmani, përgjigje dha Krenar Xhaferi, drejtor.

**Ermal Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Çfar po ndodhë në lagjen "Matiqani", kështu që pa hyrë në detaje me emra rrugësh, në përgjithësi ajo lagje është në gjendje të mjerueshme. Qytetarët nuk e kanë të çartë se a do të jetë ndërtim i lartë apo pse nuk po investohet, nga se prej ku përfundon rruga "C" tek rrethi, përpjetëza e parë është tejet e rrezikshme, ku kalojnë kamionë, e autobusë, e aty nuk ka trotuare. Kur do të fillohet me investime në Matiqan, sepse ka edhe shkollë fillore dhe nxënësit thuhetse 1 km ecin nëpër ato rrugica.

Për pyetjen e parashtruar nga z. Osmani, përgjigje dha Krenar Xhaferi, drejtor.

**Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Sportit**

- Në fshatin Prugovc, te një pjesë e shtëpive në rrugën "Selman Berisha", që 3 muaj shërbimi i kompanisë "Pastrimi" nuk e ka bërë grumbullimin e mbeturinave, kërkoi të dijë arsyen e mos marrjes së atyre mbeturinave,
- A ka ndonjë plan lidhur me renovimet e fushave të sportit në kuadër të shkollave, konkretisht për shkollën "Nexhmi Mustafa", pasi që atë fushë të sportit e shfrytëzojnë edhe fëmijët e lagjeve të katërt dhe pestë. Aty mungojnë komplet pajisjet, është fushë multifunktionale, e kanë bërë për futboll, për volejball dhe për basketboll.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Berisha, përgjigje dhanë: Besianë Musmurati, drejtoreshë, Ilirik Musliu, drejtor dhe Granit Rugova, drejtor.

**Nora Kelmendi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Administratës**

- Sheshi te katedralja apo te parkingu nëntokësor a ka përfunduar apo keni plane të tjera dhe nëse keni çfarë plane keni,
- Pse janë larguar matësit e knaqshmërisë së qytetarëve me shërbime në Komunën e vjetër dhe në Komunën e re,
- Pse nuk është duke funksionuar kioski në Komunën e re, ku qytetarët kanë pasur mundësi të marrin shërbime kadastrale, pra çertifikatat e pronës, për deri sa jeni të lidhur me rrjetin e Agjensionin Kadastral,
- A keni kontratë valide me Postën e Kosovës, siç ka qenë më herët, pasi që qytetarët duhet të paguajnë ekstra, duhet të bëjnë pagesë për shërbimet e tyre, konkretisht flas për Komunën e re, ku qytetarët për shërbime kadastrale paguajnë 50 cent ekstra pagesën për marrjen e dokumentit.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Kelmendi përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar dhe Bersant Beka, drejtor.

**Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për kryetarin e Komunës**

- Disa kompani tashmë zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Komunën e Prishtinës, a i kanë vendosur këta mbushës elektronik, nëse nuk i kanë vendosur cilat janë masat të cilat i keni ndërmarrë që të njëjtit t'i vendosin,
- Kur do të ketë transport urban për Zllatar, për lagjen "Sofalia", dhe lagjen "Arberia", pasi që për në lagjen "Arberia", linja për në këtë lagje qarkullon shumë rrallë. Po ashtu mungon transporti urban për në rrugën ish "Bledi",
- Kur do të furnizohen me ujë te pijshëm banorët e fshatit Bërnice, problem që ende vazhdon të jetë për banorët e Bërnices, ndërkohë që zgjidhja e tij është me vendosjen e disa pompave shtytëse,
- Në Bardhosh, rruga "Burimi" dhe rruga "Ekrem Dili", gjatë fushatës zgjedhore 2021 të zgjedhjeve lokale, kishte filluar zgjerimi i këtyre rrugëve, por dhe sot e kësaj dite këto rrugë janë në gjendje të njëjtë, nuk janë asfaltuar,

- Çfarë ka ndodhur me rastin e objektit "Beni Dona" në lagjen "Lakrishta", bëhet fjalë për tejkalimin e lejes që është konstatuar nga punëtorët e inspeksionit. Cilat janë veprimet pasuese të cilat janë marrë në këtë drejtim,
- Sa është numri i personave me nevoja të veçanta që janë të punësuar në Komunë dhe në ndërmarrjet publike komunale,
- Cilat janë veprimet që i ka ndërmarrë ekzekutivi i Komunës për ndërtimin e një shkolle në fshatin Shkabaj,
- Cilat janë masat që i ka ndërmarrë ekzekutivi i Komunës rreth orarit për furnizimin e marketeve, dyqaneve dhe subjekteve të tjera, operatorëve ekonomikë etj,
- Banorët e lagjes "Mati 1" kanë kërkuar që të merren masa në sanimin e një grope në një punishte afër banesave të kompleksit "Relax" dhe e cila paraqet rrezik permanent për banorët, ku tashmë në at vend kanë filluar të dalin në sipërfaqe edhe ujërat e zeza,
- Pse nuk po procedohet tutje fillimi i ndërtimit për aneksin e shkollës "Pavarësia",
- Cilat janë veprimet që i ka ndërmarrë ekzekutivi i Komunës në lidhje me gjetjen e një toke për ndërtimin e objekteve me banim të përbalueshëm.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Sveçla përgjigje dhanë: Ilirik Musliu, drejtor, Besianë Musmurati, drejtoreshë, Florian Dushi, drejtor, Krenar Xhaferi, drejtor, Përparim Rama, kryetar dhe Arbër Sadiku, drejtor.

**Faton Zeka, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit**

- Banorët afër rrugës "SylejmanVokshi" kanë një shqetësim rreth një objekti aty mbrapa "Burger Kingut", ku në at objekt është bërë një intervenim e nuk dihet se a ka leje apo është pa leje, ku sipas banorëve është pa leje. Shqetësimi i banorëve është se gjatë punimeve mendohet se kanë prekur në mure të brendshme- shtyllat mbrojtëse, sepse aty jetojnë mbi 30 familje në atë objekt dhe ndihen të rrezikuara nga punimet që i ka zhvilluar ai operatorë dhe çfarë keni ndërmarrë deri më tani për ndërprerjen e punimeve,
- Në lagjen "Kalabria", aty ku banoj mungon ndriçimi publik dhe a është ndërmarr ndonjë hap në rregullimin e ndriçimit të kësaj pjese të lagjes,
- Kam kërkuar që për linjën e autobusit 7 C, të jetë edhe një pikë ndalimi, stacion për autobusin, i cili prej kur ndalet tek kulla e parë e arabëve deri tek Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka pikë ndalimi tjetër dhe është një distancë shumë e gjatë mes këtyre dy pikave,
- Ka një kohë që ka filluar të ndërtohet një objekt në lagjen "Kalabria", i cili nuk e ka asnjë plan që e tregon se çfarë leje ndërtimi ka. Ne si banorë po dëshirojmë me e ditë se a është duke u ndërtuar ndonjë objekt publik, shkollë, çerdhe, pishinë, apo baza e AKI-së apo diçka tjetër meqë për këtë nuk ka asnjë njoftim.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Zeka, përgjigje dhanë: Ilirik Musliu, drejtor, Florian Dushi, drejtor dhe Arbër Sadiku, drejtor.

**Triera Kasumi - Berisha, për drejtorin e Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, për kryetarin e Komunës dhe për përfaqësuesin e Zyrës ligjore.**

- Kërkoji të dijë se me çfarë buxheti do të veprojë Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, me që këtë drejtori nuk e kemi paraparë më herët,
- Pse është ndërruar ushtrues detyre i shefit të Departamentit të prokurimit, a po mos ka kjo të bëjë në lidhje me ndonjë kallëzim penal që janë drejtuar ndaj tij,
- Pyetja konkretisht ka të bëjë mbi autorizimin e operatorit ekonomik i cili e përfaqëson ligjërisht Komunën e Prishtinës. Është një autorizim i cili e ka një numër të konsiderueshëm të avokatëve, autorizim i cili përfshinë të gjitha nivelet e autorizimit në një autorizim për të gjithë, ku ceket specifikisht që të gjithë këta persona të autorizuar kanë të drejtë të arrijnë edhe marrëveshje me palën.

Me intereson ta di se cilat janë këto marrëveshje që i ka arritur, cili do prej atyre të autorizuarve në bazë të atij autorizimi. Po ashtu kërkoji të dijë arsyen se, përse nuk po publikohen në Prishtinë online.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Kasumi - Berisha, përgjigje dhanë: Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Përparim Rama, kryetar dhe Valbona Makolli, drejtorë.

**Rashit Gashi, për kryetarin e Komunës, për nënkryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit**

- Disa trafostacione që janë nëpër fshatra apo lagje të ndryshme, rryma ose tensioni është shumë i ulët dhe nuk po i plotëson nevojat e qytetarëve. A keni negociuar ndonjëherë me KEDSIN-in, që banorëve të këtyre zonave me ju bërë ndonjë zgjidhje, konkretisht në fshatin Mramor, në lagjen Suteskë, ku aty është trafo e re, është një dalje rezervë mjaftojnë 350 m kablo dhe zgjidhet problemi për diku 17 shtëpi dhe rregullohet tensioni,
- Disa nënkontraktorë të Komunës të cilët po kryejnë punë, po i hapin gropat e po e lënë në gjendje jo të mirë rrugën, e do të ishte mirë që menaxherët e kontratave në këto raste me i përcjellë pak, me i adresuar, që asfalti kur të prehet të kthehet në gjendjen e mëparshme e mos me e mbushë me mallter,
- Në rrugën "Garibaldi", rrugë një kahore për autobusë, për taksitë edhe shenjat e trafikut kanë mbetur në zonë të gjelbër, vetëm i kanë hedhur e nuk i kanë larguar. Shtyllat anti-parking të plastikës janë të dëmtuara thuajse shumica, konkretisht në rrugët "Qamil Hoxha", "Fehmi Agani", "Sylejman Vokshi", "Adrian Krasniqi,
- Para një viti ia kemi aprovuar KOST-it transferimin e linjave të tensionit të lartë në një zonë tjetër, në zonë publike nga ajo private ku është sot Central Park e deri më sot nuk ka vazhduar asgjë. Linjat e tensionit janë në atë gjendje edhe pse i keni dhënë leje. Tash atij që ia keni dhënë nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk i ka tjetërsuar në atë pjesë. Madje po shohim edhe ndërtime të përkohshme që po vazhdojnë nëpër terren dhe me sa e dijë rregulloren e kemi shfuqizuar dhe nuk e di a është problem që kanë mbetur lejet nga e kaluara, konkretisht tek "Tregu i Gjelbër" në Zonën industriale për Fushë Kosovë e që prap po vazhdojnë.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Gashi, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar, Arbër Sadiku, drejtor dhe Krenar Xhaferi, drejtor.

*Kumrije Shabani - Ramadani ju bëri thirrje të gjithë qytetarëve të Prishtinës, anëtarëve të Kuvendit dhe ekzekutivit të Komunës që, të dielën më 2 prill në ora 14:00 të marrin pjesë në "Marshin për drejtësi", që të gjithë ne të bashkuar të marshojmë në sheshin "Zahir Pajaziti" duke u nisur nga sheshi "Skënderbeu".*

### **Radie Hoxhaj, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- Në lagjen "Bregu i Diellit", aty afër te ambulanta, rruga "Hyzri Talla" pse nuk kemi autobusë edhe pse aty është pritorja për autobus. Për të shkuar në qytet kemi linjën nr.3, mirëpo për t'u kthyer nuk kemi, duhet me linjën nr 4 dhe në këmbë, kështu që ne duhet për ta përshkuar tërë këtë rrugë prej shkollës "Ismail Qemali" me shumë rreziqe, me një tufë qenesh, e ndonjëherë edhe pa ndriçim e kështu me radhë.

Për pyetjen e parashtruar nga znj. Hoxhaj, përgjigje dha Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

### **Nora Kelmendi, për Drejtorinë e Shëndetësisë**

- Shpallja për 5 stomatologë të përgjithshëm të cilën e keni pasur është bërë përmes sistemit të menaxhimit të Burimeve njerëzore, por aplikimi është bërë përmes Zyrës pritëse në Komunën e vjetër. Pse është anashkuar sistemi, pse aplikuesit nuk kanë pasur mundësi të aplikojnë përmes sistemit të Burimeve njerëzore, pse ka ndodhur kjo dhe pse shpallja nuk ka qenë në veb faqen e Komunës.

Për pyetjen e parashtruar nga znj. Kelmendi, përgjigje dha Izet Sadiku, drejtor.

### **Besart Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Banorët afër rrugëve: "Shaban Jashari", "Ekrem Dili", "Rexhep Rama" dhe "Shpataj" në fshatin Bardhosh, kanë kërkuar rregullimin e tyre për shkak se janë në gjendje të rëndë,
- Po ashtu është kërkesë edhe e banorëve nga fshati Bërnice e Epërme, ku konkretisht kërkojnë të bëhet rregullimi i rrugëve "Musli Gashi" dhe "Afrim Hajrizi", si dhe në Bërnicën e Epërme kërkojnë të bëhet rregullimi i rrugëve pa emra,
- Gjithashtu edhe banorët e fshatit Llukar kërkojnë që të bëhet rregullimi i rrugës kryesore që lidh fshatrat e Gollakut me kryeqytetin, fjala është për rrugën "Bastri Canolli" e cila është në gjendje mjaft të rëndë, ku ka nevojë jo vetëm të asfaltohet por edhe të rregullohen trotualet, sepse ka mungesë të tyre,
- Kërkesë tjetër është edhe nga banorët e lagjes "Arbëria" që kërkojnë të bëhet ndriçimi tek shkallët e Arbërisë. Po ashtu aty janë edhe dy kroje të cilat nuk funksionojnë, dëshirojnë të bëhet funksionalizimi i atyre dy krojeve, gjithashtu dëshirojnë një linjë të rregullt të autobusëve, sepse siç thamë edhe më herët ka mungesë të autobusëve për shkak që është vetëm një linjë private në atë pjesë.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Krasniqi, përgjigje dha Krenar Xhaferi, drejtor.

### **Triera Kasumi- Berisha, për kryetarin e Komunës, dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit**

- Kur do ta kemi Rregulloren e re për "Prishtina Parking", pa si që në mungesë të saj po bëhen shumë keqpërdorime rreth menaxhimit të parkingjeve, kështu që e kam bërë një propozim që të bëhet një komision mbrojtës i softuerit për menaxhimin e parkingjeve, meqë

- kemi marrë nga sinjalizuesit e ndërmarrjes një njoftim ku kemi pa që për afro 40 mijë euro në muaj janë keqpërdorur. Bazuar në këtë gjendje, mendoj që rregullorja nuk duhet të kalojë pa e analizuar mirë se si kemi me e siguruar ndërmarrjen që të mos ketë kësi keqpërdorime,
- Po ashtu më intereson ta dijë prej Drejtorisë së Inspeksionit, meqë parashihet që ka me shqiptuar gjoba, a keni autorizim prej organeve kompetente për me i gjobitur qytetarët për parkingun. E dimë që ky ka qenë një problem jo i vogël për të gjithë qytetarët e Prishtinës. Gjatë gjithë mandatit kam bërë kërkesë edhe në zyrën e kryetarit që me pas një dokument i cili na jep një autorizim nga Ministria e Punëve të Brendshme, autorizim ky që policia e autorizon qoftë drejtorinë qoftë ndërmarrjen për shqiptimin e gjobave.

Për pyetjen e parashtruar nga znj. Kasumi - Berisha, përgjigje dha Florian Dushi, drejtor.

*Mbledhja përfundoi në orën 16:40.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina

